




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

**Strategjia Afatmesme e Punës së Ministrisë së Administrimit të
Pushtetit Lokal 2009-2012**



Prishtinë
20 nëntor 2008

Përmbajtja:

Faqe:

3. Fjala e Ministrit
4. Hyrje
5. Dispozitat kushtetuese
7. Misioni dhe Mandati i MAPL-së
8. Financimi
9. Legjislacioni i Ri
10. Planet e reja
11. Zbatimi i reformave të pushtetit lokal
12. Komunat
14. Struktura e Ministrisë
15. Popullsia
16. Çështjet kryesore
17. Objektivat e MAPL-së
19. Analiza e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës
20. Objektivi strategjik 1
25. Objektivi strategjik 2
30. Objektivi strategjik 3
35. Objektivi strategjik 4
39. Objektivi strategjik 5

Fjala e Ministrit

Strategjia Afatmesme e Punës e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 2009-2012, paraqet tërësinë e objektivave dhe synimeve të Ministrisë të cilat dalin nga mandati i saj dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Zbatimi i politikave të Qeverisë së Kosovës në fushën e qeverisjes lokale për të ngritur kualitetin e shërbimeve në rrafshin lokal, në bashkëpunim me komunat e Kosovës është mision i MAPL-së.

Jam i vetëdijshëm për vështirësitë të cilat do të paraqiten në rrugën drejt përmirësimit të kushteve dhe të cilësisë së jetës së qytetarëve të vendit tonë, por me angazhimin dhe përkushtimin e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal si dhe të partnerëve ndërkombëtar, duke zbatuar praktikat më të avancuara të qeverisjes lokale, do të na mundësojnë eliminimin e sfidave në ecjen tonë.

Sukseset në fushën e vetëqeverisjes demokratike lokale do ta ofrojnë Kosovën përkrah demokracive të botës dhe integrimeve në mekanizmat ndërkombëtarë.

Me këtë dokument nuk synojmë t'i vëmë pikë përpjekjeve për hulumtimin e rrugëve më të mira drejt përsosjes së qeverisjes lokale, andaj pres çdo sugjerim qëllimor i cili do të ndihmonte në këtë drejtim.

Me respekt,

Sadri Ferati

Ministër i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Hyrje

Strategjia Afatmesme e Punës e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), është dokument i cili përmban tërësinë e aktiviteteve të cilat Ministria do t'i ndërmerret me qëllim të përsosjes së funksionimit, promovimit dhe afirmimit të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe mandatit të saj.

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe veprimeve të cilat dalin nga kjo strategji, bazuar në Kushtetutën dhe ligjet e vendit, do të bëhet jo vetëm nga niveli i pushtetit lokal por edhe nga segmente të caktuara të atij qëndror.

Në qendër të vizionit të MAPL-së është reforma e vetëqeverisjes lokale të cilën qytetarët do ta konsideronin si e drejtë, obligim dhe përgjegjësi për të drejtuar proceset zhvillimore nëpër njësitë komunale. Për të arritur këtë mision, Ministria ka paraparë objektivat e mëposhtëm të cilët kanë të bëjnë me: rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, sigurimin e burimeve njerëzore me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve publike në komuna, arritjen e standardeve evropiane sipas planit për veprim për partneritet evropian, si dhe në vendosjen e kornizës legale të bashkëpunimit ndërkomunal e ndërkufitar.

Secili prej objektivave ka synimet e caktuara të cilat mund të realizohen nëpërmjet projekteve të udhëhequra nga MAPL, partnerët politik dhe organizata të ndryshme në kuadër të kornizës kohore të paraparë 2009-2012.

Me këtë strategji tentohet të arrihet nivel i lartë i funksionimit harmonik dhe modernizimit të drejtimit të pushtetit lokal në pajtim me Kartën evropiane për vetëqeverisjen lokale, duke eliminuar praktikën e moslejimit të ushtrimit të kompetencave “të zgjedhura” nga ana e komunave të cilat do të duhej t'i takonin atyre.

Dispozitat kushtetuese

Principet dhe të drejtat bazë të qeverisjes lokale përshkruhen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Sistemi qeverisës në Kosovë është i ndarë në dy nivele, atë qendror dhe lokal.

“Kushtetuta jonë përvijon ndarje të qartë të tri pushteteve të para - legjislativit, ekzekutivit, dhe gjyqësorit - gjë që siguron barazpeshimin e kontrolluar të sistemit pushtetor në tërësi, për të krijuar një pushtet koheziv demokratik, jo autoritar.”
(Dr. Fatmir Sejdiu, Presidenti i Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008)

Në kapitullin X, neni 123 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, [Qeverisja Lokale dhe Organizimi Territorial], jepen parimet e përgjithshme për vetëqeverisjen lokale:

1. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.
2. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.
3. Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.
4. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

1. Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunitetet gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.
2. Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.
3. Komunitetet kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
4. Komunitetet kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.

5. Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

6. Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.

7. Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.

Misioni i MAPL-së

Misioni i Ministrisë është avancimi cilësor i qeverisjes së pushtetit lokal, në bashkëpunim me strukturat e zgjedhura dhe zyrtarët komunal për të siguruar shërbime të përgjegjshme dhe efektive në shërbim të qytetarëve.

Mandati i MAPL-së

- Zhvillon politika dhe zbaton legjislacionin për vetëqeverisje efikase komunale
- Promovon dhe afirmon të drejtat e vetëqeverisjes së organeve lokale në pajtueshmëri me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale.
- Ushtron funksione në fushën e administratës lokale, siç është e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Koordinohet me ministritë sektoriale për ofrimin efektiv të shërbimeve që kontrollohen nga qendra, duke përfshirë resurset njerëzore dhe financiare.
- Koordinohet me Ministrinë e Financave për të siguruar që administrata komunale ka marrë burimet e duhura financiare për të ushtruar përgjegjësitë e tyre, përfshirë investimet publike.
- Kontribuoj në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore në nivel lokal,
- Mbikëqyrë funksionimin e komunave në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Kujdeset për mbarëvajtjen e planit të veprimit për partneritet evropian në fushën e pushtetit lokal.

Financimi

Ministria është formuar në fund të vitit 2005. Me Rregulloren 2008/13 buxheti i MAPL-së i rishikuar është 7.733.404,00 Euro, me një personel prej 92 vetash. Ministria është përballur me shtim të detyrave dhe zvogëlim të resurseve. Një pasqyrë e vogël e buxhetit të MAPL-së është paraqitur në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	2008	2009
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL		
Pagat dhe shtesat	356.830,00	356.830,00
Mallra dhe shërbimet	626.884,00	532.851,00
Shpenzimet komunale	85.000,00	13.000,00
Subvencionet dhe transferet	437.249,00	437.249,00
Investimet kapitale	6227.441,00	6.677.441,00
Rezerva		3.266.988,00
Totali	7.733.404,00	11.284.359,00

Për vitin 2009 në MAPL është paraparë të jetë një përbërje prej 107 punëtorësh.

Komunat

Burimet financiare të autoriteteve lokale duhet të jenë proporcionale me përgjegjësitë e përcaktuara me kushtetutë dhe me ligj.

Komunat financohen nga të hyrat vetanake, të gjeneruar në nivel lokal dhe nga granti qeveritar. Granti iu ndahet atyre nga një Komision qeveritar për ndarje të granteve. Kuvendet e komunave i përcaktojnë buxhetet e tyre duke ndjekur rregullat dhe direktivat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Përgjatë viteve të kaluara buxhetet komunale kanë qenë (në miliona euro):

	2004	2005	2006	2007
Grantet	141.8	128.3	132.5	136.3
Vetananake	34.0	45.8	34.0	28.0
Totali	175.8	174.1	166.5	164.3

Gjatë kësaj periudhe komunat kanë pasur ngritje të përgjegjësisive, dhe në të shumtën e rasteve, ngritje të numrit të popullatës. Vitet 2009-2012 paraqesin një periudhë kur përgjegjësitë e komunave do të rriten në vazhdimësi.

Në përgjigje të kësaj ligji i ri për financat lokale përcakton grantin e përgjithshëm të komunave në 10% e të ardhurave të Kosovës. Kjo duhet të stabilizoj dhe përmirësoj fuqinë e buxhetit të komunave.

Legjislacioni i Ri

Me 17 Nëntor 2007 në Kosovë janë mbajtur zgjedhjet për Parlamentin e Kosovës, për Kuvendet Komunale dhe Kryetarët e Komunave. Në prioritete kryesore të kësaj qeverie është definuar decentralizimi dhe reformat në pushtetin lokal. Me qëllim që këto objektiva të qeverisë të zbatohen në tërësi MAPL-ja ofron këtë plan legjislativ Afatmesëm për periudhën 2009-2012.

Ligji për vetëqeverisje lokale

- Gjatë periudhës 2009-2012 komunat e Republikës së Kosovës do të funksionojnë me Ligjin për vetëqeverisje lokale i cili është në harmoni të plotë me Aneksin III të planit të Ahtisaarit. Ligji do të përmirësohet me qëllim të eliminimit të kolizioneve me ligjet sektoriale.

Ligji për zgjedhjet lokale

- Mandati i strukturave aktuale komunale është 2 vjeçar, deri në nëntor të vitit 2009. Zgjedhjet e reja do të organizohen në bazë të ligjit të ri mbi zgjedhjet lokale dhe mandati i kryetarëve të komunave do të zgjatë katër vite. Ligji do të pësojë ndryshime pas konsultimeve në mes të partive politike lidhur me modelin dhe procedurat e votimeve.

Ligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete

- Normimi i bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe krijimit të partneriteteve do të bëhet me ligj.

Ligji për Menaxhimin e Pronës Komunale

- Definimi i pronës komunale (të luajtshme dhe të paluajtshme) dhe menaxhimi i saj nga komunat duhet rregulluar me ligj.

Ligji për Emërtimin e Komunave dhe Vendbanimeve

- Kjo fushë është e mbuluar pjesërisht me ligjin për kufijtë administrativ të Komunave por jo edhe emërtimi i vendbanimeve, fshatrave.

Ligji për Zhvillim Rajonal

- Me ligj do të përcaktoheshin segmentet zhvillimore për zhvillim ekonomik rajonal duke përfshirë numër më të madh të komunave të Kosovës.

Rishqyrtimi i ligjeve sektoriale

- Pasi të miratohen ligjet e reja kryesore, do të fillojë puna në sqarimin e çështjeve të decentralizimit për funksione të ndryshme sektoriale, si arsimit dhe shëndetësia

Planet e reja

Ministria është ndikuar nga një numër planesh të përgatitura gjatë periudhës 2005-2007 dhe parasheh plane të reja, si dhe ndryshimin e planeve ekzistuese gjatë periudhës 2009-2012. Kjo përfshinë edhe programin e qeverisë për 2008-2011.

Prioritetet qeveritare 2008-2011

Programi i qeverisë për vitin 2008-2011 pohon që pushteti lokal në Kosovë duhet të bazohet në Kartën Evropiane për Vet-qeverisje Lokale. Programi gjithashtu identifikon 6 prioritete strategjike:

- Ngritjen e kapacitetit financiar të komunave;
- Kompletimin e strategjive zhvillimore dhe planeve të komunave;
- Ngritjen e kapaciteteve administrative përmes shërbimeve të përbashkëta;
- Zhvillimin e qasjes elektronike të shërbimeve (e-qeverisja);
- Legjislacioni për referendum lokal, bashkëpunimi ndërkufitar dhe regional, dhe organizimi i qyteteve të mëdha;
- Kthimin e kompetencave 'të humbura' nga komunat.

a) Plani i veprimit për decentralizim

Në Maj 2007 MAPL-ja ka përgatitur një plan, i cili ka përcaktuar veprimet kryesore që duhet të ndërmerren për implementimin e Kushtetutës. Veprimet kryesore të kërkuara nga plani janë:

- Krijimi i një organi të gjerë qeveritar për koordinimin e zbatimit të decentralizimit.
- Reformimi i legjislacionit që afekton qeverisjen lokale, përfshirë edhe ndryshimin dhe rishqyrtimin e ligjeve ekzistuese.
- Krijimin e komunave të reja përfshirë edhe përcaktimin e statusit të Pilot Njësive Komunale dhe konsultimet me komunitetet joshumicë.
- Mbajtja e një fushate informuese dhe vetëdijësuese që do t'i ndihmonte qytetarët që ta kuptojnë procesin e decentralizimit.
- Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të implementimit.

Për ta vazhduar këtë agjendë qeveria më 3 prill 2008 ka aprovuar planin zbatues me qëllim që njësitë komunale:

- Të kenë kufijtë e tyre administrative të shënuar qartazi
- Të kenë sistem zgjedhor demokratik nga i cili do të dalin organe legjitime
- Të kenë përgjegjësitë dhe kompetencat e përcaktuara dhe të garantuara me ligj
- Të kenë burime të mjaftueshme financiare dhe autonomi financiare për të përmbushur përgjegjësitë e saj
- Të kenë kapacitete njerëzore dhe administrative për të ushtruar përgjegjësitë e saj dhe për të ofruar shërbime qytetarëve të saj

Zbatimi i reformave të pushtetit lokal

Për të arritur këtë, nën udhëheqjen e grupit ndër-ministorë për decentralizim janë formuar katër nën-grupe si dhe nëngrupi për fushatë:

Grupi punues për Reformë të legjislacionit – të koordinoj të gjitha ligjet e reja, reformën e ligjeve, dhe harmonizimet e nevojshme për sistemin e pushtetit lokal.

Grupi punues për formimin e komunave të reja – të bëhen rregullimet për tranzicion para mbajtjes së zgjedhjeve në komunat e reja dhe të asistoj në themelimin ligjor, financiar, administrativ dhe fizik të komunave pas zgjedhjeve.

Grupi punues për bartje të kompetencave dhe burimeve – për të siguruar ndarje të qartë të kompetencave në mes të nivelit qendror dhe lokal për të gjitha komunat.

Grupi punues për ngritje të kapaciteteve dhe zhvillim të komunave – për të adresuar çështje të kapaciteteve komunale përmes trajnimeve dhe të sigurohet asistencë e huaj dhe lokale për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture.

Grupi për fushatën informuese për decentralizim- për të organizuar një fushatë për sensibilizim të qytetarëve lidhur me efektet e decentralizimit në përmirësimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

b) Plani i Veprimit për Partneritet Evropian

Plani i Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) është miratuar nga Qeveria e Kosovës në korrik të vitit 2008, ky plan përcakton kërkesat gjithëpërfshirëse të lidhura me pjesëmarrjen e Kosovës në Procesin e Stabilizim-Asociimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Shumë veprime të PVPE, krijojnë obligime për sektorin e qeverisjes lokale, përfshirë:

- Zbatimi i legjislacionit të ri për vetëqeverisjen lokale;
- Shtimi i resurseve njerëzore, teknike dhe administrative në MAPL;
- Fushata për informimin dhe ngritjen e vetëdijes qytetare;
- Monitorimi, koordinimi dhe mbështetja për komunat;
- Masat për mbështetje të komuniteteve jo-shumicë përfshirë çështjet gjuhësore dhe çështjet e qasjes në dokumentet zyrtare, bilanci i shpenzimeve, kthimin e personave të zhvendosur;
- Përgatitjet për strategjitë e zhvillimit ekonomik;
- Masat për përmirësimet buxhetore dhe të auditimit;
- Transferimi i shërbimeve sociale;
- Përmirësimet në shëndetësi, arsim dhe shërbime publike për qytetarët;
- Rregullimi i çështjeve të banimit dhe të pronave përfshirë edhe lagjet joformale;
- Implementimi i ligjit për trashëgiminë kulturore;
- Miratimi i rregulloreve që mbështesin të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore;

c) Strategjia dhe Plani Zhvillimor i Kosovës

Puna preliminare për krijimin e Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës është kryer gjatë vitit 2007. Megjithatë, për këtë punë nuk është arritur miratimi përfundimtar, ekzistojnë disa elemente të rëndësishme që duhet të shqyrtohen sa i përket sektorit të qeverisjes lokale, përfshirë:

- Infrastrukturën sociale
- Arsimin dhe zhvillimin profesional
- Rritja e numrit të të punësuarve
- Gjithëpërfshirja sociale

d) Plane tjera të rëndësishme

Bujqësia dhe Plani për Zhvillimin Rural 2007-2012

Plani i Kosovar i Veprimet për Ambient 2006-2010

Plani Hapësinor i Kosovës (Draft) Prill 2006

Strategjia për zhvillimin e arsimit 2007-2017

Komunat

Ministria e Administrimit të pushtetit Lokal në bazë të mandatit të saj ligjor përkrah dhe mbikëqyrë aktivitetet e Komunave drejt promovimit të qeverisjes së mirë, respektimit të parimeve kushtetuese, ligjit dhe Kartës Evropiane për vetëqeverisje Lokale. Për punën e komunave, MAPL raporton në baza periodike të rregullta.

Me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale përcaktohen kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave kurse me Ligjin për Kufijtë e Komunave, përcaktohen kufijtë dhe zonat kadastrale në përbërje të tyre. Kosova ka 38 komuna. Qyteti i Prishtinës do të rregullohet me ligj të veçantë.

Komunat financohen nga të hyrat vetanake, të gjeneruar në nivel lokal dhe nga grantet ndër-qeveritare. Granti iu ndahet atyre nga një Komision qeveritar për ndarje të granteve. Kuvendet komunale i përcaktojnë buxhetet e tyre duke ndjekur rregullat dhe direktivat e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.


Përgjatë viteve të kaluara buxhetet komunale kanë qenë:

	2004	2005	2006	2007
Grant	141.8	128.3	132.5	136.3
Vetan.	34.0	45.8	34.0	28.0
Totali	175.8	174.1	166.5	164.3


Gjatë kësaj periudhe komunat kanë pasur ngritje të përgjegjësive, dhe në të shumtën e rasteve, ngritje të numrit të popullatës. Periudha 2009-2012 paraqet një kohë kur përgjegjësitë e komunave do të rriten në vazhdimësi.

Në përgjigje të kësaj ligji i ri për financat lokale zgjidh grantin e përgjithshëm të komunave në 10% e të ardhurave të Kosovës. Kjo duhet të stabilizoj dhe përmirësoj fuqinë buxhetore të komunave.

Struktura e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal



Divizionet:



Popullsia

Në bazë të vlerësimit të komunave popullata e Kosovës është 2.6 Milion. Të dhënat e përafërta zyrtare tregojnë për 2.2 Milion. Regjistrimi i popullsisë duhet të bëhet në vitin 2009. Vlerësimi nga komunat ka qenë se 45% e popullsisë janë nën moshën 25 vjet dhe 5% e popullsisë është mbi 65 vjet. Ndërsa mësimin në shkolla fillore dhe të mesme e ndjekin rreth 450,000 nxënës dhe në studime universitare rreth 30,000 student.

Mungesa e të dhënave të sakta demografike është një nga sfidat kryesore për planifikimin e mëtutjeshëm.

Territori

Kosova ka një territor prej 10,908 km². Kosova është e ndarë në 38 komuna. Struktura e madhësisë së komunave është si më poshtë:

Popullsia	Nr. i Komunave
1 - 10,000	7
10 - 25,000	5
25 - 50,000	9
50 - 100,000	9
100 - 250,000	7
300 - 500,000	1
Gjithsejtë	38

Rritja e numrit të komunave të vogla është një sfidë shtesë për resurset e kapaciteteve administrative të qeverisjes lokale.

Ekonomia dhe infrastruktura

Bizneset e regjistruara	58912
Të papunët e regjistruar	319240
Toka bujqësore	477000 hektarë
Rrugët lokale	4193 km
Familje me asistencë sociale	40459
Nr i shk. fillore dhe të mesme	702
Numri i objekteve shëndetësore	411

Çështjet kryesore

- Përafrimi me strukturat evropiane
- Miratimi i legjislacionit kryesor
- Formimi i komunave të reja
- Regjistrimi i popullsisë
- Vlerësimi i reformës
- Kompletimi i Planeve Lokale për Zhvillim Ekonomik
- Sistemi i E-qeverisjes për shërbimet kryesore për qytetarë
- Përafrimi i numrit të punëtorëve të administratës komunale me ato të regjionit

Objektivat e MAPL-së

Moto e punës së MAPL-së do të jetë:

REFORMIM, DECENTRALIZIM, DEMOKRATIZIM, STABILIZIM, EVROPIANIZIM

Bazuar në mandatin e saj, MAPL në periudhën 2009-2012 ka këto objektiva para vetes, realizimi i të cilëve do të krijon bazë të mirë për komunat që ato të qeverisin në mënyrë të efektshme dhe të përgjegjshme.

STRATEGJIA AFATMESME E PUNËS SË MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL 2009-2012

Objektivat

Objektivi Strategjik 1	Objektivi strategjik 2	Objektivi strategjik 3	Objektivi strategjik 4	Objektivi strategjik 5
VAZHDIMI I REFORMIMIT TË PUSHTETIT LOKAL DHE DECENTRALIZIM GJITHPËRFSHIRËS FUNKSIONAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	DECENTRALIZIM FISKAL I QËNDRUESHËM DHE ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL I BARASPESHUAR	NGRITJA E KAPACITETEVE PËR UDHËHEQJE MODERNE, ADMINISTRATË PROFESIONALE DHE DREJTIM KOMPETENT ME KOMUNAT	RRITJA E PJESËMARJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARJE DHE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL	RRITJA E VAZHDUESHME E CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL, NDËRKUFTARË DHE REGIONAL TË KOMUNAVE ME QËLLIM TË ARITJES SË STANDARDEVE EVROPIANE
Veprime operative strategjike 1-3 Plane operative	Veprime operative strategjike 1-3 Plane operative	Veprime operative strategjike 1-3 Plane operative	Veprime operative strategjike 1-3 Plane operative	Veprime operative strategjike 1-3 Plane operative

Analiza e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës

Reformat në organizimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë kanë marrë dinamikën e saj pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit mbi Kufijtë e Komunave dhe atij për Financat Lokale.

Përparësitë:

- Garantimi me kushtetutë i vetëqeverisjes lokale;
- Vetëqeverisja lokale në Kosovë ka një traditë relativisht të gjatë të funksionimit;
- Vetëqeverisja lokale është e orientuar kah qytetari;
- Mundësia e kontrollit dhe e vlerësimit të pushtetit lokal nga qytetari dhe të interesuarit.

Dobësitë:

- Centralizimi i disa nga kompetencave të cilat do të mund të ushtroheshin nga Komunitat;
- Ndarje jo e qartë kompetencave të dy niveleve të qeverisjes në vend;
- Komuna me dallime të mëdha territoriale, ekonomike, dhe të popullsisë;
- Mosfunksionimi i plotë i pushtetit në komunitat me shumicë serbe;
- Bashkëpunim jo i mjaftueshëm në mes të komunave;
- Të hyrat jo të baraspeshuara dhe jo të mjaftueshme të cilat prodhojnë zhvillim ekonomik jo të barabartë dhe shërbime publike të cilësisë së njëjtë;
- Varshmëria e komunave nga niveli qendror për të krijuar politika zhvillimore;
- Pamundësia e ushtrimit të kompetencave mbi pronën e komunave;
- Mungesa e ekspertëve të lëmive të ndryshme nëpër komuna.

Mundësitë:


- Ratifikimi i Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe zbatimi i përvojave të mira evropiane në këtë fushë dhe të financave lokale;
- Zbatimi me kohë i reformave të pushtetit lokal;
- Bartja me kohë e pronësisë komunave;
- Funksionalizimi i e-qeverisjes;
- Përkrahja nga ana e donatorëve për zhvillim të komunave;
- Zhvillim dhe kyçje në fondet për zhvillim rajonal;
- Zhvillimi i formave të përshtatshme të të hyrave komunale;
- Funksionimi i tregut të kapitalit, i sistemit të kreditimit dhe huamarrjes në komuna;
- Zhvillimi i partneritetit në mes të sektorit publik e privat në ekonominë e komunave;
- Modernizimi i administratës;
- Ngritja e kapaciteteve udhëheqëse;
- Kyçja e shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes;
- Krijimi i qendrës së specializuar për zhvillim të vetëqeverisjes lokale, Institutit për Vetëqeverisje Lokale.

Reziqet:

- Moshvillimi i plotë apo i pjesërishëm i reformave në vetëqeverisjen lokale;
- Kujdesi i pamjaftueshëm i pushtetit qendror për nivelin lokal;
- Reformimi i ngadalshëm i politikave tatimore dhe të hyrave komunale;
- Ndarja pa kriter dhe jotransparente e mjeteve për komunat;
- Planifikimet joadekuate për zhvillim;
- Vonesat në procesin e privatizimit;
- Mungesa e strategjive zhvillimore për fusha të ndryshme;
- Moshbesimi dhe frika nga ndryshimet me strukturat e reja;
- Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve;
- Inercioni i varshmërisë së pushtetit lokal nga ai qendror;
- Jogadishmëria e kyçjes së njerëzve me kualitete në punët publike nga “lufta” politike joparimore;
- Ndikimet politike;
- Mungesat financiare.


OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:

VAZHDIMI I REFORMIMIT NË PUSHTETIN LOKAL DHE DECENTRALIZIMI GJITHPËRFSHIRËS FUNKSIONAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS



Veprimi operativ strategjik 1.1


Vazhdimi i procesit të decentralizimit



- Vazhdimi i bartjes së kompetencave prej pushtetit qendror në atë lokal dhe harmonizim i legjislacionit me ligjin për vetëqeverisje lokale.
- Shpërndarje dhe bartje e pasurisë nga pushteti qendror në atë lokal të harmonizuara ndërmjet pushteteve.
- Ngritja e kapaciteteve (përpunimi i vijave të komunikimit) sektoriale nëpër ministritë përkatëse dhe komuna (arsim, urbanizëm, shëndetësi, politikë sociale, kulturë, ambient jetësor, energji) për bashkëpunim ndërmjet pushteteve,
- Ngritja e institucioneve të specializuara (institut, akademi, shkollë) për çështje të pushtetit lokal,
- Komunikim efikas me opinionin publik në procesin e decentralizimit.

Veprimi operativ strategjik 1.2

Vazhdimi i reformave në pushtetin lokal



- Themelimi i komunave të reja sipas ligjeve në fuqi.
- Përgaditja e opinionit publik për reformat në pushtetin lokal.
- Ngritja e kapaciteteve përkatëse në komunat me kompetenca shtesë.
- Ngritja e kapaciteteve për monitorim dhe kontrollë në pjesën e kompetencave shtesë.
- Qasje e planifikuar dhe harmonizimi i veprimeve në mes sektorëve, faktorit politik vendas dhe ndërkombëtarë me popullatën në teren.
- komunikim kualitativ ndërmjet faktorëve që marrin pjesë në procesin e reformave.
- inkurajim i komuniteteve pakicë, posaçërisht ati sërb për pjesëmarrje aktive në proces.

Veprimi operativ strategjik 1.3

Përkrahja e komunave në zbatim të reformave dhe në decentralizim



- Përkrahja në organizimin dhe sistemimin e burimeve njerëzore nëpër komuna.
- Përkrahje në vendosjen e instrumenteve sektoriale (plane zhvillimi, urbane-stike, mjedisor, investues)
- Përkrahje në definimin e detyrave në vendimarrje, strategjike, drejtuese dhe operative.
- Përkrahje në avansimin e shkathhtësive koperuese dhe bashkëpunim të institucioneve komunale në mes vete dhe me pushtetin qendror.
- Përkrahje në pregaditjen e planeve që kërkojnë përfshirjen e tërësishme të të gjitha niveleve të pushtetit.

PROGRAMET PËRCJELLËSE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVIT STRATEGJIK 1

1. Reformimi territorial dhe decentralizimi i pushtetit lokal;
2. Vazhdimi i kompletimit të infrastrukturës ligjore në bashkëpunim me ministrinë Tjera;
3. Definimi i kompetencave në relacionin pushtet qendror/ pushtet lokal;
4. Konsultimi i pakicave etnike rreth formimit të komunave të reja;
5. Bashkëpunon me Zyrën Civile Ndërkombëtare(ZCN) lidhur me komunat e reja;
6. Punon në rregullimin me ligj të qytetit të Prishtinës;
7. Ndhmon komunat në përmirësimin e shërbimeve kadastrale dhe urbanistike;
8. Në bashkëpunim me Ministrinë e linjës koordinohet procesi i delegimit të përgjegjësive dhe kompetencave komunale;
9. Ndhmon në formimin e strukturave të reja komunale;
10. Ofron trajnime për strukturat e reja komunale;
11. Krijon metodologjinë për mbikëqyrje të ligjshmërisë së veprimeve komunale;
12. MAPL, së bashku me komunat do të punojë fuqishëm në ndërtimin e infrastrukturës publike dhe përpilojnë planet zhvillimore komunale, ato rregullative urbane si dhe vendosjen e instrumenteve të qëndrueshme për plane mjedisore komunale;
13. Kontribuon në identifikimin e sistemit zgjedhor lokal të përshtatshëm;
14. Vlerëson procesin e reformave dhe propozon zgjidhje.

Veprimi operativ strategjik 1.1

Vazhdimi i procesit të reformimit dhe të decentralizimit të pushtetit lokal:

Koment:

Procesi i reformimit dhe i decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë është në një fazë mjaft të përparuar. Ligjet bazë janë aprovuar por ekziston një numër ligjesh që duhet të aprovohen dhe një pjesë tjetër e ligjeve duhet të amendamentohen me qëllim të harmonizimit me ligjin bazë, Ligjin për vetëqeverisje lokale. Janë caktuar ekipe në nivel ndërministror me pjesëmarrje të ndërkombëtarëve për të qar përpara këto dy procese. Në këtë fazë nuk është bërë bartja dhe regjistrimi i pasurisë komunale si dhe nuk është sa duhet i zhvilluar koordinimi i aktiviteteve ndërmjet sektorëve të pushtetit qendrorë me atë lokal. Kjo kërkon ngritjen e kapaciteteve të specializuara vendore për përgatitje të institucioneve qendrore dhe lokale për procesin e decentralizimit. Për shkak të kompleksitetit dhe politizimit të këtij procesi është i nevojshëm sqarimi dhe komunikimi i drejtë i aktiviteteve të ndërmarra opinionit më të gjerë publik.

Rezultatet e pritura:

Kosova të ketë një legjislacion të kompletuar dhe të harmonizuar që rregullon mënyrën e funksionimit të pushtetit vendorë, rregullimin e çështjeve pronësore-juridike të pasurisë komunale, administratë mirë të koordinuar në nivele të ndryshme të pushtetit në vijë horizontale dhe vertikale, opinion publik pozitivisht i orientuar në procesin e decentralizimit dhe të përgatitur që ti kuptoj përparësitë e pushtetit vendorë.

Projektet që do të lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik do të jenë:

1. Vazhdimi i kompletimit të infrastrukturës ligjore në bashkëpunim me ministritë tjera,
2. Definimi i kompetencave në relacionin pushtet qendror/pushtet lokal,
3. Puna në nxjerrjen e ligjit të qytetit të Prishtinës,
4. Puna në rrybullakimin e kornizës ligjore e cila ka të bëjë me pushtetin lokal,
5. Ndihma në krijimin e strukturave të reja komunale,
6. Përgatitja e trajnimeve për strukturat e reja komunale,
7. Nxjerrja e dokumentit me vlerësimet lidhur me të arriturat dhe vështirësitë e funksionimit të pushtetit lokal,

Dinamika e paraparë:

Procesi i aprovimit të legjislaturës të mbaroj gjer në fund të viti 2009. Bartja e pasurisë evidentimi dhe regjistrimi i pasurisë deri në fund të vitit 2010, kurse trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve vendore deri në fund të vitit 2011.

Veprimi operativ strategjik 1.2

Vazhdimi i reformave në pushtetin lokal

Koment:

Republika e Kosovës me ligjin për kufijtë komunal dhe ligjin për vetëqeverisje lokale duhet të themeloj komuna të reja dhe me kompetenca shtesë. Këto komuna do të duhet të akomodojnë komunitetet pakicë e posaçërisht atë serb në Kosovë. Kjo çështje është shumë e ndjeshme politikisht dhe kërkon bashkëpunim ndërmjet faktorit politik vendorë dhe ati ndërkombëtarë e posaçërisht bashkëpunimin me komunitetin serb. Kompetencat shtesë që duhet të ushtrohen në nivel lokal kërkojnë një administratë shumë profesionale dhe një koordinim të aktiviteteve ndërmjet pushtetit qendrorë dhe ati lokal.

Rezultatet e pritura:

Kosova do të ketë një decentralizim funksional efikas dhe efektiv në tërë territorin e sajë. Komunitetet pakicë e posaçërisht ai serb do të marrë pjesë aktive në jetën publike dhe politike në nivel lokal por edhe do të bashkëpunoj efektshëm me pushtetin qendrorë në kryerjen e kompetencave vetanake dhe atyre shtesë. Komunitat e reja të kenë administratë të përgatitur në kryerjen e detyrave të dhëna me ligj. Opinioni kosovar ta kuptojë drejtë dhe ta mirëpresë qëllimin e kësaj asimetrie.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Konsultimi i pakicave etnike rreth formimit të komunave të reja;
2. Bashkëpunon me ZCN lidhur me komunat e reja;
3. Ndihmon në formimin e strukturave të reja komunale;
4. Ofron trajnime për strukturat e reja komunale.

Dinamika e paraparë:

Themelimi i komunave të fillojë në vitin 2008 dhe të vazhdojë në vitin 2009. Funksionalizimi dhe ushtrimi i kompetencave shtesë të filloj së zbatuari në vitin 2010.

Veprimi operativ strategjik 1.3

Përkrahja e komunave në zbatim të reformave dhe të decentralizimit:

Koment:

Bartja e kompetencave dhe zbatimi i plotë i tyre kërkojnë një monitorim dhe një përkrahje të fortë nga pushteti qendrorë. Kjo përkrahje duhet orientuar në ngritjen dhe funksionalizimin e instrumenteve me të cilët do të mundësohet implementimi i ligjeve dhe kompetencave që dalin nga këto ligje. Do të jetë i nevojshëm zhvillimi i

instrumenteve sektoriale dhe planifikim afatshkurtër dhe afatmesëm në shumë lëmi për të cilët pushteti qendrorë do të mund ta jep ndihmesën e tyre. Ndarja e pushteteve dhe detyrave në nivel lokal kërkon shkathtësi dhe njohuri të posaçme për një funksionim efikas të komunave dhe zbatim të ligjshmërisë.

Rezultatet e pritura:

Komunat të kenë të ngritur dhe zhvilluar sektorët përkatës që mundësojnë implementim të plotë të kompetencave posaçërisht në lëmit si urbanizmi, menaxhimi me resurse njerëzore në arsim etj. Komunat do të jenë të gatshme për përgatitjen e planeve afatmesme dhe afatgjata. Institucionet të kenë të zhvilluar bashkëpunimin në mes vete si dhe të rritet kapaciteti në vendimmarrje dhe udhëheqje me komunën dhe institucionet komunale.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:


1. Krijon metodologjinë për mbikëqyrje të ligjshmërisë së veprimeve komunale,
2. MAPL do të punojë fuqishëm në ndërtimin e infrastrukturës publike dhe përpilojnë planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbane dhe planet rregullative urbane,

Dinamika e paraparë:

Ngritja e sektorëve duhet të mbarojë për komunat deri në fund të vitit 2008 kurse ato me kompetenca shtesë gjer në vitin 2009. Aprovimi i planeve afatmesme dhe afatgjatë deri në vitin 2010. Ngritja e kapaciteteve të bëhet në vazhdimësi.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:

DECENTRALIZIM FISKAL I QËNDRUESHËM DHE ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL I BARASPESHUAR



Veprimi operativ strategjik 2.1

Roli vendimtar i vetqeverisjes lokale në menaxhimin me resurse lokale dhe në ngritjen e të hyrave vetanake



- Zhvillimi modeleve me qasje integrale në ndarjen e grondeve
- Zhvillimi i modeleve për posedim dhe menaxhim me pasurinë lokale,
- Ngritja e modeleve për një udhëheqësi të përgjegjshme financiare,
- Përpunimi i sistemit normativ për arritjen e synimeve të objektivit strategjik 2.

Veprimi operativ strategjik 2.2

Menaxhment financiar kualitativ dhe planifikim shumëvjeçar, qasje në tregun e kapitalit



- Ngritja e qendrave informative me baza të të dhënave me parametra socio ekonomik dhe financiare të komunave,
- Zhvillimi i moduleve për planifikime shumëvjeçare të buxhetit komunal dhe investimeve kapitale
- Formimi i kritereve për vlerësim të komunave që mund të marrin pjesë në tregun e kapitalit.

Veprimi operativ strategjik 2.3

Promovim i instrumenteve efikase në përkrahjen e komunave të cilat ngecin në zhvillim



- Definimi i kritereve për vlerësimin e nivelit të zhvillimit të komunave
- Seleksionimi i komunave me resurse të ulta zhvillimore,
- Promovimi i instrumentit të "ekualizimit" të komunave,

PROGRAMET PËRCJELLËSE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVIT STRATEGJIK 2

1. Përmirësimi i funksionimit të formulës së granteve/komisionin e granteve;
2. Bëhet vlerësimi i kostos dhe analizimi i raporteve periodike për shpenzimet komunale;
3. Përkrahja dhe inkurajimi i komunave të hartojnë strategjitë e zhvillimit komunal sipas metodologjive të vendosura dhe standardeve ndërkombëtare;
4. Rritja e të hyrave komunale duke krijuar një sistem të qëndrueshëm të të hyrave me synim të ngritjes së të hyrave komunale me 5% të buxhetit total për vit;
5. Dizajnimi dhe zbatimi i një procesi vjetor të rishqyrtimit të resurseve;
6. Ndryshimi i bazës së resurseve komunale në bazë të rishikimit të reformës së qeverisjes lokale;
7. Rrjetëzimi i zyrave për ndihmë bizneseve në komuna, si dhe të shoqatave të bizneseve në nivel lokal;
8. Sensibilizimi i donatorëve dhe i qeverisë për investime në komunat të cilat janë më pak të zhvilluara;
9. Përgatitja e komunave për të absorbuar donacionet dhe fondet e ndryshme;
10. Bashkëpunimi me ministritë e linjës në ndërtimin e kornizës ligjore për t'i hapur rrugë investimeve ekonomike në komuna;
11. Stimulon komunat për t'i kompletuar planet e tyre hapësinore;
12. Zhvillon të dhënat objektive për qeverisje lokale për nevoja të komunitetit të donatorëve;
13. Krijimi i mekanizmit përcjellës për projektet e donatorëve;
14. Angazhim i veçantë në fokusimin, dizajnimin dhe zhvillimin e fiskalitetit lokal në mënyrë që komunat të disponojnë me buxhete të qëndrueshme për financimin e aktiviteteve komunale dhe të realizimit të projekteve infrastrukturore për nevojat e qytetarëve;
15. Komunat do të përkrahen dhe inkurajohen të hartojnë strategjitë e zhvillimit komunal sipas metodologjive të vendosura dhe standardeve të pranuar ndërkombëtare;
16. Kujdesi i MAPL-së që komunat të kenë zhvillim të njëtrajtshëm ekonomik;
17. Inventarizimi i tërësisë së pasurisë komunale.

Veprimi operativ strategjik 2.1.

Roli vendimtar i vetqeverisjes lokale në menaxhimin me resurse lokale dhe në ngritjen e të hyrave vetanake

Koment:

Komunat e Kosovës nuk kanë të pasqyrë të qartë për rolin e tyre në resurset lokale. Ndarja e granteve që vinë nga qeveria nuk kanë politika të qarta aftëgjate dhe integrale. Komunat duhet të kenë rol vendimtar në ndarjen e tyre. Udhëheqja dhe menaxhimi me resurse lokale është e një rëndësie të veçantë. Nuk ka sisteme normative të ngritura për arritjen e objektivave strategjike.

Rezultatet e pritura:

Komunat do të kenë të qartë rolin e tyre në posedimin dhe menaxhimin me resurset lokale. Komunat do të jenë të përgatitur që në mënyrë autonome të menaxhojnë me resurset lokale. Komunat do të kenë rol vendimtarë në ndarjen e granteve dhe në mënyrën e shpërndarjes.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Përmirësimi i funksionimit të formulës së grandeve/komisionin e grandeve;
2. Rritja e të hyrave komunale duke krijuar një sistem të qëndrueshëm të të hyrave me synim të ngritjes së të hyrave komunale me 5% të buxhetit total për vit;
3. Rrjetëzimi i zyrave për ndihmë bizneseve në komuna, si dhe të shoqatave të bizneseve në nivel lokal;
4. Angazhim i veçantë në fokusimin në dizajnimin dhe zhvillimin e fiskalitetit lokal në mënyrë që komunat të disponojnë me buxhete të qëndrueshme për financimin e aktiviteteve komunale dhe të realizimit të projekteve infrastrukturore për nevojat e qytetarëve.

Dinamika e paraparë:

Zhvillimi i modeleve në qasje në grante dhe hartimi i strategjive të zhvillimit të komunave si dhe i projekteve në kuadër të këtij objekti do të bëhen deri në fund të vitit 2011.

Veprimi operativ strategjik 2.2

Menaxhment financiar kualitativ dhe planifikim shumëvjeçar, qasje në tregun e kapitalit.

Koment:

Decentralizimi fiskal duhet të bëhet gradualisht dhe me kohë të harmonizohen dhe definohen kompetencat e dy niveleve të qeverisjes me qëllim që komunat në të ardhmen të bëhen faktor kyç në menaxhim të pasurisë komunale dhe të kenë të hyra adekuate për të realizuar obligimet e tyre ndaj qytetarëve në mënyrë sa më efikase dhe të përgjegjshme.

Rezultatet e pritura: Duke bërë definimin dhe harmonizimin e kompetencave si dhe duke ua mundësuar komunave menaxhimin me pasurinë e tyre dhe me pjesën e granteve qeveritare do të krijoheshin përparësi që komunat të sigurojnë burime për funksionim të qëndrueshëm dhe kualitativ të organeve komunale sipas nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Dizajnimi dhe zbatimi i një procesi vjetor të rishqyrtimit të resurseve.
2. Ndryshimi i bazës së resurseve komunale në bazë të rishikimit të reformës së qeverisjes lokale;
3. Rrjetëzimi i zyrave për ndihmë bizneseve në komuna, si dhe të shoqatave të bizneseve në nivel lokal;
4. Sensibilizimi i donatorëve dhe i qeverisë për investime në komunat të cilat janë më pak të zhvilluara;
5. Përgatitja e komunave për të absorbuar donacionet dhe fondet e ndryshme.
6. Bashkëpunimi me ministritë e linjës në ndërtimin e kornizës ligjore për t'i hapur rrugë investimeve ekonomike në komuna në mënyrë që ato të kenë qasje në tregun e kapitalit për investime kapitale;
7. Angazhim i veçantë në fokusimin, dizajnimin dhe zhvillimin e fiskalitetit lokal në mënyrë që komunat të disponojnë me buxhete të qëndrueshme për financimin e aktiviteteve komunale dhe të realizimit të projekteve infrastrukturore për nevojat e qytetarëve.
8. Inventarizimi i tërësisë së pasurisë komunale.
9. Krijimi i bazës së të dhënave për zhvillimin ekonomik për secilën komunë.

Dinamika e paraparë:

Realizimi i projekteve lidhur objektivin strategjik 2.2 të filloj nga viti 2009 dhe do të jetë proces i vazhdueshëm.

Veprimi operativ strategjik 2.3

Promovim i instrumenteve efikase në përkrahjen e komunave të cilat ngecin në zhvillim.

Koment:

Struktura e komunave në Kosovë në aspektin zhvillimor është heterogjene, me mundësi jo të baraspeshuar zhvillimi për arsye të burimeve dhe të hyrave të ndryshme. Nevoja e stimulimit të komunave të pazhvilluara nga grandet qeveritare dhe donacioneve nga jashtë do të ishte një formë e mirë e zhvillimit harmonik të tyre.

Rezultatet e pritura:

Do të zhvillohen praktika dhe instrumente të cilat do të ndikonin në shpejtimin e zhvillimit të komunave me dinamikë më të ulët zhvillimi.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:


1. Komunitat do të përkrahen dhe inkurajohen të hartojnë strategjitë e zhvillimit komunal sipas metodologjive të vendosura dhe standardeve të pranuar ndërkombëtare;
2. Krijimi i mekanizmit përcjellës për projektet e donatorëve;
3. Sensibilizimi i donatorëve dhe i qeverisë për investime në komunitat të cilat janë më pak të zhvilluara;
4. Përgatitja e komunitave për të absorbuar donacionet dhe fondet e ndryshme.

Dinamika e paraparë:

Hartimi i projekteve dhe realizimi i tyre bëhet nga viti 2009.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

NGRITJA E KAPACITETEVE PËR UDHËHEQJE
MODERNE, ADMINISTRATË PROFESIONALE DHE
DREJTIM KOMPETENT ME KOMUNAT



Veprimi operativ strategjik 3.1

Ndërtimi i udhëheqjes moderne komunale

- Definimi i karakteristikave dhe rolin e udhëheqësit modern në komunë.
- Promovimi i konceptit të udhëheqësisë moderne në komunë.
- Definimi dhe promovimi i instrumentave në rolin e dyfishtë të kryetarit të komunës atë të liderit dhe të drejtuesit.
- Zhvillimi i programeve për udhëheqje moderne me vlera multikulturore dhe multi gjuhësore.

Veprimi operativ strategjik 3.2

Krijimi i programeve dhe institucione vendore për ngritje profesionale të udhëheqësve dhe trajnime të administratës komunale

- Definimi dhe promovimi i modelit udhëheqës modern në komuna.
- Definimi dhe promovimi i menaxhimit kompetent nëpër administratat komunale.
- Ngritja e vazhdueshme profesionale e stafit të administratës komunale.
- Përgatitja e moduleve nga ana e qendrave të specializuara për përgatitjen e udhëheqësisë moderne dhe administratë profesionale.

Veprimi operativ strategjik 3.3

Hartimi i planeve vjetore dhe afatmesme për burimet njerëzore, riorganizim të administratës komunale, për punë ekipore, për udhëheqje me projekte

- Përgatitja e planeve vjetore dhe afatmesme për ngritje të resurseve njerëzore në komuna
- Zhvillimi dhe përgatitja e një administrate komunale e prirë për punë ekipore dhe udhëheqje me projekte,
- Përkrahja e komunave në përgatitjen e strategjive për menaxhim me burime njerëzore
- Ngritja e administratave multi-etnike në komunat etnikisht të përziera

PROGRAMET PËRCJELLËSE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVIT STRATEGJIK 3

1. Vlersimi i gjendjes lidhur me kapacitetet njerëzore nëpër komuna, formimi i bazës për evidentimin e resurseve njerëzore në lëmin e decentralizimit dhe pushtetit lokal;
2. Definimi i prioriteteve në ngritje të kapaciteteve (udhëheqëse, strategjike, menaxheriale, administrative dhe teknike);
3. Programe plus për komunat me kompetenca të zgjeruara (arsim, kulturë, shëndetësi, siguri, bashkëpunim me institucionet e Serbisë);
4. Formimi i fondit të përbashkët për trajnime i MAPL-së dhe donatorëve;
5. Ngritja e një institucioni vendor të specializuar për ngritje të kapaciteteve dhe trajnime;
6. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në komuna;
7. Përgatitja e Komunave për planifikim dhe strukturim të resurseve njerëzore në baza vjetore dhe afatmesme të ngritjes profesionale;
8. Ofron dhe zhvillon trajnime për strukturat komunale të bazuara në ligjin mbi vetëqeverisjen lokale (së bashku me institucionet profesionale, IKAP-in, AKK-n);
9. Zbaton rregullat për ngritje në karrierë;
10. Programe të posaçme për rolin e liderit dhe të udhëheqësit komunal;
11. Programe për administratë komunale e orientuar nga detyra e jo nga pala;
12. Përgatitë administratë që di të udhëheqë me projekte.

Veprimi operativ strategjik 3.1

Ndërtimi i udhëheqjes moderne komunale

Koment:

Mungesa e shkathtësive udhëheqëse dhe e aftësive për të drejtuar komunat apo drejtoritë e caktuara është një realitet i cili haset në Kosovë. Nuk ka sistem të kriterëve me anë të të cilave do të vlerësoheshin të arriturat e pjesës udhëheqëse politike dhe e personelit.

Rezultatet e pritura:

Realizimi i aktiviteteve në kuadër të objektivit siguron ngritje e nivelit udhëheqës, organizativ, profesional dhe të përgjegjshëm në nivel lokal. Ndikimi i liderit në rritjen e motivit për punë dhe krijimit të ambientit për realizimin e planeve zhvillimore do të jenë produkt i veprimit operativ strategjik 3.1.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Formimi i fondit të përbashkët për trajnime i MAPL-së dhe donatorëve;
2. Programe të posaçme për rolin e liderit dhe të udhëheqësit komunal;
3. Programe për administratë komunale e orientuar nga detyra jo klienti;
4. Përgatitë administratë që di të udhëheqë me projekte;
5. Zhvillon trajnime për udhëheqje moderne në komuna;
6. Zbaton rregullat për ngritje në karrierë.

Dinamika e paraparë:

Rishqyrtimi i aktiviteteve të deritanishme dhe përsosja e tyre me qëllim të ngritjes së aftësive dhe shkathtësive organizative dhe udhëheqëse do të filloj menjëherë. Këto aktivitete do të jenë vazhdimësi e punës së MAPL-së.

Veprimi operativ strategjik 3.2

Krijimi i programeve dhe institucione vendore për ngritje profesionale të udhëheqësve dhe trajnime të administratës komunale

Koment:

Kosova ka deficit të institucioneve trajnuese dhe programeve për ngritje profesionale të të punësuarve në shërbime publike. Institutet e llojit "Think Tank" të cilat do të merreshin me këtë natyrë të punëve do të ndihmonin avancimin profesional të të punësuarve.

Rezultatet e pritura:

Brenda viteve 2009-2010 funksionalizohet **Instituti Kosovar për Vetëqeverisje Lokale**. Hartohen programe për udhëheqje politike dhe profesionale. Deri në fund të vitit 2011 të gjitha komunat realizojnë trajnime për ngritje profesionale me qëllim të promovimit të vetëqeverisjes lokale në pajtim me dinamikën e decentralizimit të pushtetit lokal.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Ngritja e **Institutit Kosovar për Vetëqeverisje Lokale** për ngritje të kapaciteteve dhe trajnime;
2. Përcaktimi i prioritetëve në ngritje të kapaciteteve udhëheqëse, strategjike, menaxheriale, administrative dhe teknike;
3. Me institucionet ndërkombëtare harton dhe organizon trajnime për komunat e reja.

Dinamika e paraparë:

Realizimi i programeve përcjellëse të objektivit synohen së realizuari deri në vitin 2011.

Veprimi operativ strategjik 3.3

Hartimi i planeve vjetore dhe afatmesme për burimet njerëzore, riorganizim të administratës komunale për punë ekipore për udhëheqje me projekte

Koment:

Puna nëpër komunat e Kosovës shpeshherë zhvillohet në koncepte të mbyllura, burokratike dhe pa interakcion në mes të sektorëve të caktuar, me mungesë të nismave të reja dhe pa plane të afatizuara në fushën e burimeve njerëzore.

Rezultatet e pritura:

Krijimi dhe promovimi i modeleve të reja organizative, të përshtatshme për specifikat e komunave të cilat do të japin efekte pozitive.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Vlersimi i gjendjes lidhur me kapacitetet njerëzore nëpër komuna, formimi i bazës për evidentimin e resurseve njerëzore në lëmin e decentralizimit dhe pushtetit lokal.


2. Përgatitja e administratës inovative, e cila zbaton punën ekipore, e cila di të krijoj dhe të udhëheqë me projekte.
3. Programe për administratë komunale e orientuar nga detyra e jo për palën.

Dinamika e paraparë:

Realizimi i këtij veprimi strategjik duhet filluar në vitin 2009, kurse efektet do të jenë rezultative në fund të vitit 2012 me synim të vazhdimit të ngritjes së mëtejme.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

ZHVILLIMI I DEMOKRACISË SË DREJTPËRSËDREJTË,
RRITJA E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË
VENDIMMARRJE DHE NË KRIJIMIN E POLITIKAVE NË
NIVELIN LOKAL



Veprimi operativstrategjik 4.1

Përgatitja e një mase kritike qytetarësh nga vendbanimet dhe shërbyes administrativ për pjesmarje aktive në veprimatri publike



- Kampanjë informative dhe edukative për pjesmarje të qytetarëve në vendimarrje në nivel lokal,
- Ngritja e instrumenteve për përcjelljen dhe vlerësimin e pjesmarjes së qytetarëve në vendimarrje,
- Definimi i raporteve pushtet lokal/vendbanim (fshat, lagje apo vendbanim)
- Afirmimin e komunave si vend ku te drejtat e komuniteteve ne vendimarrje jan te plota

Veprim operativ strategjik 4.2

Garantimi i rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në demokracinë e drejtëpërdrejtë dhe në sistem zgjedhor adekuat



- Ngritja e mehanizmave efikas për pjesmarje të qytetarëve në vetqeverisjen lokale,
- Ngritja e vetëdijes për demokracinë e drejtëpërsëdrejtë
- Rritjen e interesimit tek komunitetet pakicë e posaqërisht atij serb per demokracinë lokale
- Perkrahje aktiviteve qytetare që kanë karakter multietnik

Veprim operativ strategjik 4.3

Garantim në rritjen e vetëdijes te komunat se sektori joqeveritarë dhe mediuemet lokale janë bashkëndërtues të demokracisë lokale



- Krijimi i ambientit pozitiv për funksionim të sektorit joqeveritarë dhe mediuemeve lokale
- Prompvimi partneritetit publik me sektorin joqeveritar dhe ate privat,
- Kërkime interaktive për matjen e nivelit të zhvillimit të mediuemeve lokale dhe ndikimi i tyre në demokracinë lokale.

PROGRAMET PËRCJELLËSE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVIT STRATEGJIK 4

1. Promovimi i idesë “demokracia lokale parakusht për demokraci shtetërore”;
2. Zhvillimi i formave të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike (përfaqësim formal, deskriptiv, simbolik, esencial);
3. Zhvillimi i demokracisë së drejtëpërsëdrejtë tradicionale (referendum, këshilli komunal, prezantim publik, diskutim publik);
4. Ngritja e lirive dhe të drejtave të njeriut në nivelin lokal;
5. Vendosja e demokracisë së drejtëpërdrejtë nëpërmjet formave moderne (shoqata të ndryshme, veteran lufte, ndërkulturore, ekologjike, të përndjekurit etj), komentet me internet, telefon kujdestar, etj;
6. Rritja e pjesëmarrjes së OJQ-ve në sektorin e pushtetit lokal;
7. Krijimi i bazës së të dhënave për OJQ-të që mbështesin komunat;
8. Ngritja e rrjetit të mediave lokale dhe kyçja e tyre në monitorimin e komunave;
9. Kyçja e sektorit të biznesit në debate publike gjatë aprovimit të planeve zhvillimore dhe buxheteve;
10. Programe për motivim të komuniteteve për tu kyçur në jetën publike;
11. Zhvillimi i ideve për një sistem stabil zgjedhor të pushtetit lokal;
12. Zhvillim i modaliteteve për zgjedhjen e udhëheqjeve të vendbanimeve, fshatrave.

Veprimi operativ strategjik 4.1

Përgatitja e një mase kritike qytetarësh nga vendbanimet dhe shërbyes administrativ për pjesëmarrje aktive në veprimtari publike

Koment:

Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe shoqërisë civile për pjesëmarrje në jetën publike dhe në vendimmarrje edhe më tutje nuk është në nivel të duhur. Realizimi i pjesëmarrjes së tyre në këtë drejtim do t'i kontribuonte rritjes së besimit të qytetarëve ndaj pushteteve, sidomos atij lokal.

Rezultatet e pritura:

Qeverisja lokale do të jetë më e pranishme në mesin e qytetarëve dhe do të ndërtohet një kulturë më relaksuese politike në relacionin qytetar, shoqëri civile/pushtet lokal. Do të ndërtohet kornizë e normuar, formale për të rregulluar raporte të qëndrueshme në mes të qytetarëve dhe pushtetit lokal.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Zhvillimi i formave të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike (përfaqësim formal, deskriptiv, simbolik, esencial);
2. Vendosja e demokracisë së drejtpërdrejtë nëpërmjet formave moderne (shoqata të ndryshme, veteran lufte, ndërkulturore, ekologjike, të përndjekurit etj.), komentet me internet, telefon kujdestar, etj.;
3. Rritja e pjesëmarrjes së OJQ-ve në sektorin e pushtetit lokal;
4. Krijimi i bazës së të dhënave për OJQ-të që mbështesin komunitat;
5. Ngritja e rrejtës së medieve lokale dhe kyçja e tyre në monitorimin e komunave.

Dinamika e paraparë:

Në vazhdimësi që nga viti 2009.

Veprimi operativ strategjik 4.2

Garantimi i rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe në sistem zgjedhor adekuat

Koment:

Kryesisht, deri tani në Kosovë qytetarët janë përfaqësuar në institucionet e pushtetit nëpërmjet të demokracisë së tërthortë, nëpërmjet të zgjedhurve e jo në formë të drejtpërdrejtë. Kjo do të rregullohet nëpërmjet ligjit për referendum. Forma e zgjedhjeve të organeve të pushtetit lokal ende është duke vibruar.

Rezultatet e pritura:

Vendosja e normativave të cilat sigurojnë vendimmarrjen e drejtpërdrejt nga qytetarët në nivelin lokal. Futja e formave të reja të vendimmarrjes dhe i kontrollimit të punëve

publike. Përcaktimi për një formë të qëndrueshme për zgjedhjet lokale. Përmirësimi i imazhit të pushtetit lokal.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Zhvillimi i demokracisë së drejtpërdrejtë tradicionale (referendum, këshilli komunal, prezantim publik, diskutim publik);
2. Zhvillimi i ideve për një sistem stabil zgjedhor të pushtetit lokal;;
3. Zhvillim i modaliteteve për zgjedhjen e udhëheqjeve të vendbanimeve, fshatrave;
4. Promovimi i partneritetit në mes të sektorëve publik, joqeveritar dhe atij privat në zhvillimin e demokracisë lokale.

Dinamika e paraparë:

Pas hyrjes në fuqi të ligjit mbi Referendumin fillon zbatimi i nënakteve në nivelin lokal në interes të qytetarëve. Gjatë viteve 2009-2011 do të ketë zhvillime pozitive lidhur me objektivin strategjik.

Veprimi operativ strategjik 4.3

Garantim në rritjen e vetëdijes te komunat se sektori joqeveritarë dhe mediumet lokale janë bashkëndërtues të demokracisë lokale

Koment:

Në mes të komunave dhe sektorit joqeveritar e medieve nuk ka raporte të bazuara në respektim të misioneve përkatëse të ndërsjella. Shpeshherë, mediat dhe shoqëria civile ndikohen nga udhëheqjet lokale apo paraqiten të anshme në raport me to.

Rezultatet e pritura:

Ndërtimi i mediave të paanshme dhe të pavarura në kryerjen e misionit të tyre. Informim më i plotë dhe me kohë i opinionit publik lidhur me zhvillimet në komuna. Shtim i transparencës së aktiviteteve komunale, i demokracisë lokale dhe proceseve politike.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:


1. Promovimi i idesë “demokracia lokale parakusht për demokraci shtetërore”;
2. Ngritja e rrjetës së medieve lokale dhe kyçja e tyre në monitorimin e komunave;
3. Kyçja e sektorit të biznesit në debate publike gjatë aprovimit të planeve zhvillimore dhe buxheteve;
4. Programe për motivim të komuniteteve për tu kyçur në jetën publike.

Dinamika e paraparë:

Brenda viteve 2009-2012.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

RRIKJE E VAZHDUESHME E CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE NËPËRMJET BASHKËPUNIMIT NDËRKONUNAL, NDËRKUFITARË DHE REGJIONAL I KOMUNAVE, ME QËLLIM TË ARITJES SË STANDARDEVE EVROPIANE



Veprimi operativ strategjik 5.1

Ngritja e vazhdueshme e cilësisë dhe ekonomizimit në ofrimin e shërbimeve në komuna



-Zhvillimi i praktikave të kryerjes bashkarisht të funksioneve në realizimin e kompetencave.

- Vendosja e sistemit efikas të menaxhimit me shërbimet dhe kompanit që kryejn shërbime komunale.

-Vendosja e praktikave për shërbime elektronike.

-Aplikim të praktikave të shërbimeve publike me partner privat dhe sektor joqeveritar.

Veprim operativ strategjik 5.2

Zhvillimi i bashkëpunimit produktiv të komunave në vend dhe jashtë në realizimin e interesave të përbashkëta



-Ngritja e bashkëpunimit të MAPL-së me AKK-në në përgatitje dhe realizimin e projekteve konkrete në interes të komunave .

-Pjesmarje aktive e komunave të Kosovës në iniciativat regjionale informative dhe projekteve të përbashkëta regjionale.

-Aktivizimi i benchmarking-it (praktikat më të mira, mësim nga praktikat më të mira) si sistem për bashkëpunim dhe mësim prej të tjerëve.

-Bashkëpunim i komunave me institucionet e vendeve përreth (Sërbisë) për asistenc teknike në ushtrimin e kometencat shtesë për çështje që nuk ndërhyjnë në kompetencat e pushtetit qendrorë.

Veprime operativ strategjik 5.3

Komunat e Kosovës model evropian dhe standard i ri për komunat në regjion



-Ngritja e bashkëpunimit me institucionet e Këshillit të Evropës që meren me pushtetin vendorë.

-Zhvillim i diplomacisë lokale në funksion të stabilitetit dhe paqës.

PROGRAMET PËRCJELLËSE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVIT STRATEGJIK 5

1. Transparenca e funksionimit të pushtetit lokal dhe futja e mekanizmave të Antikorrupsionit;
1. Instalimi i teknologjive/metodologjive të përparuara për ofrim të shërbimeve administrative për qytetarët;
2. Zbatimi i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian në komuna;
3. Përgatitja e fushatës informuese për Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale;
4. Raportimi për të arriturat e qeverisjes lokale në Kosovë;
5. Fuqizimi i rolit të zyrtarëve komunal për integrim në BE nëpër komuna;
6. Përgatitja e planit për binjakëzim të komunave të Kosovës me ato të BE-së;
7. Ngritja e numrit të projekteve të përbashkëta në mes të komunave për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve posaçërisht në shërbimet publike komunale;
8. Ngritja e kapaciteteve dhe identifikimi i projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal;
9. Ngritja e kapaciteteve dhe identifikimi i projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal;
10. Përgatitja e një plani për binjakëzimin e komunave të Kosovës dhe shteteve të BE-së;
11. Përgatitja e planit gjeneral për shërbimet e përbashkëta komunale;
12. Përkrahje për komunat në formimin e partneriteteve në pajtim me ligjin;
13. Mbanë një konferencë për binjakëzim dhe shfrytëzon mësimet e marra;
14. Të gjitha komunat janë binjakëzuar me së paku një komunë në një shtet tjetër;
15. Komunat kanë zvogëluar koston e shërbimeve dhe infrastrukturës përmes bashkëpunimit ndërkomunal;
16. Zhvillon kapacitetet në fushën e diplomacisë lokale në fushën ekonomike lokale;
17. Rrjetëzimi i zyrave për ndihmë bizneseve në komuna, si dhe të shoqatave të bizneseve në nivel lokal.

Veprimi operativ strategjik 5.1

Ngritja e vazhdueshme e cilësisë dhe ekonomizimit në ofrimin e shërbimeve në komuna

Koment:

Në Kosovë mungojnë nismat nga komunat në këmbim të përvojave më të mira brenda komunave të Kosovës dhe atyre të regjionit. Deri tani ka pasur disa tentime nga mekanizmat ndërkombëtar për të realizuar këmbim përvojash dhe vendosje të bashkëpunimeve të këtilla. Bashkëpunimi në ofrimin e shërbimeve do të ulte koston e tyre.

Rezultatet e pritura:

Krijimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për bashkëpunim në mes të komunave brenda dhe jashtë Kosovës. Fuqizim i rolit të vetëqeverisjes lokale brenda vendit. Zhvillim i diplomacisë lokale. Bashkëpunim në mes të komunave me ato jashtë Kosovës. Ulje e koston së shërbimeve komunale. Binjakëzim të komunave të Kosovës me ato të vendeve tjera.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Ngritja e kapaciteteve dhe identifikimi i projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar;
2. Ngritja e kapaciteteve dhe identifikimi i projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal;
3. Përgatitja e një plani për binjakëzimin e komunave të Kosovës dhe shteteve të a. BE-së;
4. Ngritja e numrit të projekteve të përbashkëta në mes të komunave për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve posaçërisht në shërbimet publike komunale;
5. Përkrahje për komunat në formimin e partneriteteve në pajtim me ligjin;
6. Zvogëlimi i shpenzimeve për ofrim të shërbimeve dhe ngritja e cilësisë infrastrukturës përmes bashkëpunimit ndërkomunal;
7. Zhvillon kapacitetet në fushën e diplomacisë lokale dhe në atë ekonomike lokale.

Dinamika e paraparë:

Me veprime fillohet në vitin 2009. Do të jetë vazhdimësi.

Veprimi operativ strategjik 5.2

Zhvillimi i bashkëpunimit produktiv të komunave në vend dhe jashtë në realizimin e interesave të përbashkëta

Koment:

Në vitet e pasluftës janë zhvilluar praktika të mira të cilat duhet shfrytëzuar për të përmirësuar dhe futur ato ndryshime për të ofruar shërbime publike moderne.

Eliminimit të dallimeve në mes komunave në ofrimin e shërbimeve të njëjta do t'i kontribuon realizimi i veprimit strategjik 5.2.

Rezultatet e pritura:

Identifikimi i përvojave më të mira në Kosovë në ofrimin e shërbimeve publike.
Identifikimi i mekanizmave në matjen e vazhdueshme të kualitetit të jetës në nivelin lokal në Kosovë.
Eliminimi i dallimeve në ofrimin e shërbimeve nëpër komuna.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Përgatitja e planit gjeneral për shërbimet e përbashkëta komunale;
2. Instalimi i teknologjive/metodologjive të përparuara për ofrim të shërbimeve administrative për qytetarët;
3. Zbatimi i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian në komuna.

Dinamika e paraparë:

Realizimi i projekteve do të bëhet në mes të viteve 2009-2011.

Veprimi operativ strategjik 5.3

Komunat e Kosovës model evropian dhe standard i ri për komunat në regjion

Koment:

Arritja e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike komunale do të mundësohet duke realizuar Planin e Veprimit për Partneritet Evropian të pjesës e cila i takon komunave.

Në disa fusha komunat e Kosovës realizojnë më shumë të drejta se sa simotrat e tyre në regjion. Kosova ka çka i ofron regjionit dhe më gjerë në fushën e të drejtave të pakicave.

Rezultatet e pritura:

Komunat do të ofrohen standardeve të arritura të vendeve të regjionit dhe të BE-së.
Afirmim i të arriturave të komunave të Kosovës. Avancim i kulturës politike dhe stabilizim të bashkëpunimit ndërkomunal dhe me komunat e qytetet e vendeve të regjionit.

Projektet që lidhen me këtë pjesë të objektivit strategjik:

1. Zbatimi i Planit të Veprimit për Partneritet Evropian në komuna,
2. Përgatitja e fushatës informuese për Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale,
3. Fuqizimi i rolit të zyrtarëve komunal për integrim në BE nëpër komuna,
4. Zhvillon kapacitetet në fushën e diplomacisë dhe atë ekonomike lokale,

Dinamika e paraparë:

Zhvillimi i projekteve do të jetë dinamik dhe një proces i vazhdueshëm që nga viti 2009.